REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 935120
Date/Datum. 23.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**18.11.2020**	**23.11.2020**	Nr. i lëndës: **935/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.11.2020, OE "LUBOTENI - A"shpk –Shterpce, ka parashtruar ankesë me nr: **935/20**, kundër njoftimit për **Vendimit te AK te KK-Shterpce**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rritja e kapacitetit te rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Jazhince"** me nr. të prokurimit:**655-20-6103-5-2-1**,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Shterpcë (KSh).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurëtë hapur**, lloji i kontratës: **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **137 237.35€.**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së)**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shpallja e procedurës ne e-prokurim 06.10.2020

Dorëzimi i tenderit: 19.10.2020

Hapja e ofertës : 19.10.2020

Njoftimi Leter standarde:26.10.2020

Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 26.10.2020

Kerkesaper rishqyrtim: 31.10.2020

Pergjigje e AK-së: 31.10.2020

Kriteri i dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te lire

Dispozitat e shkelura te AK-së

Neni 1

Neni 6

Neni 7

Neni 27

Neni 28

Neni 52

Neni 59

Neni 69

Neni 72

Neni 108/A

Pika 9.1 & 9.2 te DT dhe NJPK te kapaciteti teknik dhe profesional.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Pretendimet ankimore te OE ankues

Ne pajtim me dispozitat e nenit 109 te LPP-se, parashtrojmë këtë ankese kundër vendimit te AK-së, Komuna Shterpc , mbi njoftimin për dhënie te kontratës dhe eliminimin tone si OE i papërgjegjshëm dhe vendimin e refuzimit te kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rritja e kapacitetit te rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Jazhincë – Komuna e Shtërpcës ", me nr.prokurimit 655-20-6103-5-2-1. AK me rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit te ofertave perketeakrivitet prokurimi ka bere:

- Vertetim te gabuar te gjendjes faktike;
- Shkelje esenciale e dispozitave te LPP-se.

Ashtu sic e kemi potencuar ne kërkesën per rishqyrtim, dhe ne kete ankese pretendojmë se Komuna e Shterpces na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit ne kundërshtim me nenin 9.1 & 9.2 sepse bazuar ne DT dhe NJK ku ne paramase dhe parallogari fare nuk ka pozicion qe do te perdoret kjo makine e cila i eshte përshtatur OE se caktuar, ne kemi ofertuar me makine e cila i plotëson qëllimin e përmbushjes se kontratës.

Nëse shiqojme DT nga paramasa nuk ka pozicion e cila kërkon qe do te perdoret kjo makine per me tepër vetëm nje pozicion ka te beje me Sanimi i dëmtimeve te instalimeve ekzistuese nentokesore dhe per te cilin nuk ka nevoje qe ajo makine te jete llazerike.

Nga kërkesat e DT vërehet qarte se ky aktivitet i prokurimit i eshte përgatit si zakonisht te vetmit person HysnirBerishes (LINDA SHPK dhe EUROINFRASTRUKTURA), pavarësisht me cilën kompani oferton, shiqoni te gjitha aktivitetet e prokurimit kush i ka fitu dhe me cilat kërkesa dhe kritere te gjitha te përgatitura vetëm per te.

Nga ajo qe u tha AK-Komuna Shterpc ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1 te LPP-se citat:

"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Poashtu AK ka shpërblyer me kontrate OE me çmim me te shtrenjte per 27 mije, ashtu qe ka vepruar ne kundërshtim me nenin 6.1 te LPP-së: "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publik edhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit"

AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 52 te LPP-së, sepse kriter per dhënie te kontratës ka qene kriteri i çmimit me te ulet, ndërsa AK ka shpërblyer me kontrate OE me çmim me te larte .

AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se, sepse nuk na ka ftuar per te sqaruar dokumentet e pretenduara nga AK.

Paragrafi 4 i nenit 59 te LPP-së thotë: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhenë dosjen e tenderit"*

AK me këtë ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7.6(v) dhe (vi) citat:
(v)qëasnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.
Nga te cekurat me larte janë evidente, te prekshme, dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues me rastin e shqyrtimit te kësaj ankese tone, konform, lidhur me tenderin: **"Rritja e kapacitetit te rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Jazhincë – Komuna e Shtërpcës ", me nr.prokurimit 655-20-6103-5-2-1,** te merr kete:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE "Luboteni-A"Shterpc, lidhur me tenderin "Rritja e kapacitetit te rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Jazhincë – Komuna e Shtërpcës", me nr.prokurimit 655-20-6103-5-2-1**

ANULOHET, njoftimi per dhënie te kontratës lidhur me tenderin "Rritja e kapacitetit te rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Jazhincë – Komuna e Shtërpcës ", me nr.prokurimit 655-20-6103-5-2-1.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Lista e pajisjeve të punës,	**Lista e pajisjeve te punës, të dëshmuar me libreze qarkullimi apo dokumentat nga dogana me fotografi për pajisjet, (ose kontratë për huazim e cila duhet të jetë e noterizuar)** **1. kamion për transport më së paku 1 (një) ,** **2. bager më së paku 2 (dy),** **3. Cilindër më së paku 1 (një)** **4. Kamion kiper më së paku 2 (dy),**

	5. Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa më së paku 1 (një) **6. Autobetonjere e vogel më së paku 1 (një)** **7. Makin për shpim horizontal nëntksor me sistem lazer të kontrollit prej DN 250--DN 1400 më së paku 1 (një)**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Tëpërshkruhetvetëmvlërësimi i ofertëssë OE ankues /ofertave, përtë cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE Grupi i Operatoreve ekonomik EUROINFRASTRUKTURA ; Ejup Shabani B.I. i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- **N/A**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: nr.935/20

Pergjigje në pretendimin e parë ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK-KomunaShtërpce lidhur me pajisjen **7. Makin për shpim horizontal nëntksor me sistem lazer të kontrollit prej DN 250--DN 1400 më së paku 1 (një).**

Eksperti i OSHP-se sqaron se OE ankues nuk e plotëson kriterin e kërkuar si ne FDT dhe NJK, dhe ne rast se ka pasur paqartësi ne kritere OE ka qene dashtë te beje ankese ne kritere deri me dt.13.10.2020 për sqarime, kurse kërkesa për rishqyrtim ka mund te behet 5 dite para hapjes se ofertës sipas paragrafit 2.3.1 te nenit 108/A thuhet: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Pra, AK e ka precizuar qartë ne dosjen e tenderit, por ne rastin konkret OE ankues nuk e ka shfrytëzuar afatin dhe te drejtën ligjore për ankese.

Pra, OE i rekomanduar e disponon pajisjen e kërkuar sipas kritereve te FDT dhe NJPK.

Edhe ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK thotë se: OE ankues nuk e ka shfrytëzuar ankesën për kritere para hapjes se ofertave siç ka qene afati ligjor.

Pra, siç pretendon OE ankues, se AK ka shkelur nenin 1,6 te LPP-së, sqaroje se AK duhet te vlerësoj sipas kërkesave te vendosura ne FDT dhe NJPK, konkretisht sipas paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-së

Pretendimi ankimor i OE ankues i pabazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelitshqyrtues që te ankesat te refuzohet si e pabazuar dhete mbetet ne fuqi vendimi i AK-se, sepse OE i rekomanduar e plotëson pajisjen e kërkuar sipas pikës 9.1 & 9.2 te FDT-se.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **Komuna Shtërpcë**
- Panelit Shqyrtues - **OSHP.**
- OE ankues - **OE. "Luboteni - A"**